



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	23 . 11 . 2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPRIMBETEK	7362/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.895/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.895/2022 të datës 12.10.2022 të parashtruar nga ankuesja Komuna e Malishevës, kundër organit të punësimit/Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 23.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.895/2022 të datës 12.10.2022, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar në Komunën e Malishevës, sipas Akt emërimit Nr.01/711 të datës 16.07.2020, në pozitën "Inspektore për Mbrojtje të Mjedisit" në Drejtorinë e Inspektoratit. Me datën 04.04.2022, Kryetari i Komunës së Malishevës ka nxjerrë Vendimin Nr.01/491, sipas të cilit nga data 05.04.2022 ankuesja është transferuar në pozitën "Zyrtare për Mjedis dhe Ambient" në Drejtorinë për Shërbime Publike.

E pakënaqur me mos kthimin në pozitën të cilën e ka mbajtur me akt emërim pas periudhës së transferimit, me datën 12.10.2022 përmes Postës së Kosovës ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6107/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar po me këtë datë, me pretendimet ankimore që Vendimi Nr.01/491 i datës 04.04.2022 i Kryetarit të Komunës së Malishevës lidhur me transferimin e saj të shfuqizohet, si dhe që kryetari i kësaj komune ta kthejë në pozitën si Inspektore për mbrojtje të mjedisit pranë Drejtorisë së Inspektoratit sipas Akt emërimit të datës 16.07.2020 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 19.10.2022, përmes shkresës me numër të protokollit 6308/2022, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Malishevës. Ndërsa Këshilli, me datën 07.11.2022, përmes shkresës me numër të protokollit 6755/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankueses nga Komuna e Malishevës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:6107/2022 të datës 12.10.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimin me numër Nr.01/457 të datës 28.03.2022 nga Kryetari i Komunës së Malishevës; Aktvendimin me numër 01/134 të datës 31.01.2022 nga Kryetari i Komunës së Malishevës; Aktvendimin me numër Nr.04/491 të datës 04.04.2022 nga Kryetari i Komunës së Malishevës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 07.11.2022 nga Komuna e Malishevës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimin e ankueses me numër Nr.01/711 të datës 16.07.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses, ka analizuar dëshmitë e ofruara nga Komuna e Malishevës dhe ka konstatuar se me datën 01.11.2022 Kryetari i Komunës së Malishevës, ka nxjerrë Vendimin Nr.01/1816 sipas të cilit e ka shfuqizuar Aktvendimin me Nr.01/491 të datës 04.04.2022, me të cilin ankuesja ishte transferuar përkohësisht nga pozita të cilën e mban me akt emërim si "Inspektore për mbrojtje të mjedisit", pranë Drejtorisë së Inspeksionit në pozitën si "Zyrtare për mjedis dhe ambient" në Drejtorinë për Shërbime Publike. Andaj duke pasur parasysh se Aktvendimi Nr.01/491 i datës 04.04.2022, i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Malishevës lidhur me transferimin e përkohshëm të ankueses është shfuqizuar, Kolegji i Këshillit konstaton se objekti i shqyrtimit të ankesës së ankueses të datës 12.10.2022 në Këshill, është bërë i pamundur ose i kotë, bazuar në konstatimet e lartcekura, e krejt kjo në pajtim me nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*", andaj edhe ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankueses

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.895/2022, datë 23/11/2022.

Avdyl Bekteshi

Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

